

Forumi i Biznesit Shqipëri - Arabia Saudite

Më datë 1 mars 2024, u zhvillua Forumi i Biznesit Shqipëri - Arabia Saudite, për të thelluar bashkëpunimin, tërheqjen e investimeve të huaja në Shqipëri dhe krijuar një klimë të favorshme për biznesin.

Një hap themelor e këtij organizimi ishte dhe Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mes dy vendeve, për Krijimin e Këshillit të Përbashkët të Biznesit, e cila do të reflektojë lehtësimin në krijimin e kontakteve, duke identifikuar partnerë potencialë, tregje të reja dhe mundësi për zgjerim nëpërmjet koordinimit nga AIDA.

Mbështetja e biznesit vendas dhe të huaj është një prioritet i Qeverisë Shqiptare dhe është e gatshme të ndërmerret iniciativa për nxitjen dhe lehtësimin e investimeve dhe bashkëpunimeve tregtare. Në fjalën e saj, Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, Znj. Laura Plaku (Saro), theksoi ndihmën dhe gadishmërinë e AIDA-s, në çdo fazë të zhvillimit të projekteve investuese.

Forumi u përmbyll me takimet B2B ndërmjet bizneseve të Arabisë Saudite dhe atyre shqiptare, duke krijuar kontaktin e parë për nisjen e partneriteteve reciproke dhe ndërkombëtarizimin.



Sesioni i takimeve B2B, i organizuar nga AIDA, midis bizneseve shqiptare dhe atyre të Arabisë Saudite, të zhvilluara në pjesën e fundit të forumit të biznesit Shqipëri-Arabi Saudite, rezultoi një sukses.

Kompanitë vendosën kontaktet e para midis tyre, me synim nisjen e bashkëpunimeve në të ardhmen.

AIDA, në kuadër të misionit të saj për tërheqjen e investimeve të huaja në vendin tonë dhe ndërkombëtarizimin e bizneseve shqiptare, do vijojë të jetë në mbështetje për të realizuar këto bashkëpunime të synuara.

Forumi i Biznesit Shqipëri - Çeki

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në bashkëpunim me Ambasadën e Republikës Çeke në Shqipëri dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, organizuan më datë 26 mars 2024, Forumin e Biznesit Shqipëri - Çeki, si një dëshmi e vullnetit të përbashkët për të thelluar bashkëpunimin ekonomik dhe eksplorimin e mundësive dypalëshe për të nxitur partneritete, si dhe investime të reja.

Forumi u përshëndet nga Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Z. Blendi Gonxhja, Ministri i Industrisë dhe Tregtisë së Republikës Çeke, Z. Jozef Sikela, Zv/Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Z. Ami Kozeli dhe Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, Znj. Laura Plaku (Saro), ku u vendos theksi në potencialin e larmishëm që Shqipëria ofron për investitorët e huaj, garantimin dhe mbrojtjen e investimeve nëpërmjet reformave të ndërmarra nga qeveria, si edhe sektorët strategjikë për investime.

Në fjalën e saj Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, Znj. Laura Plaku (Saro), u shpreh se ky është momenti për të investuar në Shqipëri dhe ftoi sipërmarrësit çek për të përfituar nga kjo mundësi dhe sesi AIDA është partneri i tyre në këtë proces, duke i garantuar bizneseve se AIDA i asiston për çdo nevojë që nga procesi i nisjes së një biznesi, apo dhe me projekt ide për të bërë biznes në Shqipëri. Znj. Plaku, prezantoi klimën pozitive të biznesit dhe arsyeve përse duhet të investojnë në Shqipëri, duke vijuar me sektorët potencial si: ICT&BPO, Turizmi, Energjia, Bujqësia dhe Manifaktura, teksa prezantoi dhe procedurën e Investimeve Strategjike. Duke besuar në potencialin e shtetit Çek, Znj. Plaku, bëri ftesën e saj për të rritur bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar midis dy vendeve.



Forumi vijoi me sesionin e takimeve B2B, ndërmjet kompanive shqiptare dhe atyre çeke, për të diskutuar mundësi konkrete bashkëpunimi dhe krijimin e partneriteteve në të ardhmen.

Ky forum ishte një iniciativë themelore, që i hap rrugë bashkëpunimeve tregtare dhe një mundësi e shkëlqyer për të shkëmbyer mundësi konkrete bashkëpunimi për të ardhmen në sektorë me interes të përbashkët.

Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ekonomik mes palës Shqiptare dhe asaj Çeke

Në kuadër të vizitës së delegacionit Çek, të kryesuar nga Ministria e Industrisë dhe Tregtisë së Republikës Çeke, u mbajtën disa evente, duke startuar me zhvillimin e Forumit të Biznesit Shqipëri – Çeki, sesionin e takimeve B2B dhe takimin përmbyllës të nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ekonomik.

Nënshkrimi i marrëveshjes dypalëshe ndërmjet Ministrisë të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Z. Blendi Gonxhja dhe Ministrisë të Industrisë e Tregtisë, Z. Josef Sikela, pasqyron angazhimin konkret për të zgjeruar grupet e punës të Komisionit Zyrtar ndërinstytucional Çeki – Shqipëri.

Gjatë takimit zyrtar, u diskutua mbi marrëdhënien ekonomike mes dy vendeve, si dhe potencialin e madh për zhvillim. Gjithashtu, u diskutua edhe vullneti i Qeverisë Shqiptare për t'i çuar me tej keto marrëdhënie, duke nxitur forma konkrete dhe dimensione të reja bashkëpunimi në fusha me interes të ndërsjelltë.



Takim kortezie me Kryetarin e Këshillit të Tregtisë së Danimarkës për Kroacinë, Shqipërinë dhe Kosovën, Z. Zarko Masanovic

Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Znj. Laura Plaku (Saro), zhvilloi një takim kortezie me Kryetarin e Këshillit të Tregtisë së Danimarkës për Kroacinë, Shqipërinë dhe Kosovën, Z. Zarko Masanovic.

Gjatë takimit u diskutua mbi prezencën e kompanive daneze në vendin tonë, sektorët që operojnë, si dhe forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit në mbështetjen e kompanive daneze që dëshirojnë të zgjerohen dhe gjejnë partner tregtar në tregun shqiptar.



Tryezë e rrumbullakët me temë “Si të rrisni vlerën e biznesit tuaj përmes pronësisë industriale”

Sot, në ambientet e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, u zhvillua tryeza e rrumbullakët me temë “Si të rrisni vlerën e biznesit tuaj përmes pronësisë industriale”. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), nga sektori i artizanatit, ITC-së dhe kozmetikës.

Takimi u hap me fjalën përshëndetëse të Drejtuesve të dy institucioneve, Znj. Laura Plaku (Saro) dhe Znj. Rovena Beqiraj, të cilat falënderuan përfaqësuesit e bizneseve që iu përgjigjën ftesës dhe prezantuan shërbimet që këto dy institucione ofrojnë në mbështetjen të NMVM-ve.

Në vijim të aktivitetit, të pranishmit u njohën me objektet kryesore të Pronësisë Industriale si: patentat për shpikjet, markat tregtare, dizenjt industrialë dhe treguesit gjeografikë, si dhe me procedurën e aplikimit për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, duke e ilustruar dhe me shembuj konkretë.



Gjithashtu, përfaqësues të AIDA-s, prezantuan disa nga shërbimet që kompanitë shqiptare mund të përfitojnë, aktivitetet që janë realizuar gjatë vitit të kaluar, si dhe disa nga objektivat që synohen të realizohen gjatë vitit 2024, që lidhen kryesisht me promovimin e NMVM-ve, produkteve shqiptare, aksesin në financë dhe rritjen e kapaciteteve drejt eksportit.

Prezantimet e mbajtura ngjallën interes për pjesëmarrësit, duke u shoqëruar me pyetje specifike dhe sugjerime.